



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRI

Numri i lëndës: 2021:213650

Datë: 08.10.2024

Numri i dokumentit: 06268246

C.nr.1102/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Leotrim Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.M, me vendbanim në V të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.B, avokate me seli në Vushtri kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) - Policia e Kosovës, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me objekt kontesti kompensim i pagës së fund vitit (13-të), jashtë seance, me datë 08.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit R.M si dhe DETYROHET e paditura MPB, që në emër të shpërblimit të pagës së fund vitit (13-të) për vitet 2018, 2019 dhe 2020 t'ia paguajë, paditësit R.M pagën prej 561.29 euro për secilin vit, në shumën e përgjithshme prej 1,683.87 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke e llogaritur nga data e paraqitjes së padisë me datë 23.09.2021, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 124.00 euro, të gjitha këto në afat prej shtatë (7) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit me të cilin ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të shujtës ditore për 700 ditë pune, në shumën prej 2.50 euro për çdo ditë pune, t'ia paguaj paditësit shumën e përgjithshme prej 1,750.00 euro.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes përfaqësuesit të tij, me datë 23.09.2021, kanë paraqitur padi, ndaj të paditurës për kompensimin e pagës së 13- të dhe shujtën ditore, të cilën e ka precizuar me datë 29.01.2024.

Pretendimet e palëve

Me padi kanë theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune në Ministrinë e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës, mirëpo që nga hyrja në fuqi e Udhëzimit Administrativ 02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, asnjëherë nuk i është kompensuar paga e 13-të e as shujta ditore, të drejta këto që i takojnë sipas nenit 29 të këtij UA dhe se kjo ka ndodhur pavarësisht se ndaj tyre nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore dhe se kanë pasur në vazhdimësi performancë të kënaqshme. Paditësi me precizimin e kërkesëpadi së datës 29.01.2024, sa i përket kërkesë për kompensimin e pagës së 13-të kanë theksuar se paditësi R.M ka pagë mujore prej 561.29 euro dhe një pagë e tillë në emër të pagës së 13-të sipas dispozitës së lartcekur, duhet t'i kompensohet atij për secilin nga vitet 2018, 2019 dhe 2020 apo në shumën e përgjithshme prej 1,683.87, kurse për 700 ditë pune të realizuara nga hyrja në fuqi e UA-së së lartcekur e deri kur është paraqitur padia më 23.09.2021, t'ia paguaj shujtën ditore prej 2.50 euro apo në shumën e përgjithshme prej 1,750.00 euro.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë 104 euro në emër të përpilimit të padisë, 20 euro për taksën gjyqësore si dhe 104 euro për përpilimin e parashtresës për precizimin e kërkesëpadi së, të dorëzuar në gjykatë me datë 29.01.2024.

E paditura ka parashtruar përgjigje në padinë me datë 09.02.2024, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, me arsyetim se kërkesëpadi a e paditëseve është e pathemeltë duke theksuar se paga e 13 nuk është realizuar për asnjë punonjës të Policisë së Kosovës, për shkak të mungesës së mjeteve financiare sepse Ministria e Financave nuk e ka aprovuar buxhetin sipas kërkesës së Policisë së Kosovës dhe në këtë kontekst ka vlerësuar se UA.nr.02/2018, sa i përket implikimeve financiare nuk ka fuqi të prodhoj efekte financiare të cilat nuk janë paraparë në Ligjin për Ndarjet Buxhetore. Ka vlerësuar se si rrjedhojë e kësaj, çdo veprim apo nismë duke përfshirë edhe nenin 29 pika 2 të UA.nr.02/2018 e Kosovës, i cili prodhon obligime financiare, nuk është i obligueshëm përderisa nuk ka identifikuar paraprakisht burimin financiar, ashtu që në mungesë të mjeteve buxhetore- financiare nuk ka mundur të realizohet pagesa e pagës së 13-të. Andaj, e paditura konsideron se nuk parashihet me asnjë dispozitë ligjore si detyrim-obligim i saj kompensimi i pagës së 13-të. I ka propozuar gjykatës të nxjerrë aktgjykim me anë të cilit e refuzon në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëseve si të pa bazuar, kurse nuk ka kërkuar shpenzime të procedurës.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka vlerësuar dhe administruar këto prova: Vërtetimi i punësimit për paditësin i lëshuar nga Policia e Kosovës, i datës 19.03.2021 dhe Formulari i përfundimit të punësimit për vitet 2018, 2019 dhe 2020 për paditësin.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë dhe kërkesëpadisë, provave të propozuara si dhe përgjigjes në padi në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, ka çmuar me kujdes dhe me ndërgjegje çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e themeltë andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, kurse në kuptim të nenit 399 të LPK-së, me dispozitivin II, e ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në mes të palëve nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, i cili fakt u vërtetua nga edhe vërtetimi i punësimit për paditësin i lëshuara nga Policia e Kosovës. Kontestuese po ashtu nuk ishte kontestuese as shuma e kërkuar e kompensimit për pagën e 13-të, as fakti se paditësi gjatë viteve 2018, 2019 dhe 2020 nuk ka pasur asnjë masë disiplinore dhe se gjatë kësaj periudhe kanë pasur performancë plotësisht të kënaqshme të vlerësimit, i cili fakt po ashtu u vërtetua nga formularët e vlerësimit të përfundimit të punësimit për vitet 2018, 2019 dhe 2020.

Kontestuese në mes palëve ishte vetëm nëse e paditura detyrohet sipas UA 02/2018 që t'ia paguaj paditësit pagën e 13-të për secilin nga vitet 2018, 2019 dhe 2020.

Nga Vërtetimi i punësimit për paditësin i lëshuar nga Policia e Kosovës, i datës 19.03.2021 për paditësin gjykata konstatoi se paditësi e ka filluar punën tek e paditura nga data 14.06.2004 dhe se paga e tij është në shumën prej 561.29 euro.

Sipas nenit 29 par 2, të Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka qenë në fuqi për periudhën kohore për të cilin paditësi e ka kërkuar kompensimin për pagën e 13-të (2018, 2019, 2020) është përcaktuar që *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”*.

Nga interpretimi i dispozitës të lartcituara të Udhëzimit Administrative 02/2018 të nxjerrë nga e paditura si dhe provave të analizuara, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëseve është e bazuar, sepse paditësi e gëzon të drejtën që në fund të çdo viti kalendarik për vitet 2018, 2019 dhe 2020 ta përfitoj si shpërblim një pagë mujore, me kusht që ato vite paditësi të ketë vlerësim të kënaqshëm të performancës së punës dhe që ndaj tij të mos jetë shqiptuar ndonjë masë disiplinore. Në këtë rast sipas formularëve të vlerësimit të performancës, që gjenden në shkresat e lëndës, konstatohet se paditësi, ka vlerësim plotësisht të kënaqshëm të performancës dhe të njëjtit për gjatë viteve 2018, 2019 dhe 2020 nuk i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore, e që kjo nuk është kontestuar as nga e paditura me anë të përgjigjes në padi.

Detyrimi i të paditurës ndaj paditëses është e përcaktuar edhe me nenin 8.1 të Ligjit nr 04/1-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është përcaktuar që *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”, kurse me nenin 245 të LMD-së është paraparë që “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, e që në këtë rast e paditura është e detyruar që të përmbushë një detyrim ndaj paditësit, ashtu siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

Prandaj gjykata me dispozitivin I, ka vendosur që e paditura që t’ia paguaj paditësit pagat e fund vitit për tri vite, në shumën e përgjithshme prej 1,683.87 euro, ngase tashmë me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme nr. 213/2023, të datës 09.10.2023, (Pika II) është unifikuar praktika gjyqësore e Kosovës sa i përket pagës së 13-të, të zyrtarëve policor, të përcaktuar me UA 02/2018, i cili mendim ka theksuar se është i papranueshëm çdo arsyetim eventual për mungesën e mjeteve buxhetore, të cilën e ka pretenduar edhe e paditura me përgjigje në padi.

Gjykata përveç kërkesës kryesore, duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 par.2 të LMD-së dhe Mendimin juridik për kamatën i Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 265/2020 i datës 02.12.2020 paditëseve i’a njohu edhe të drejtën në kamatë ligjore, në lartësi prej 8% në vit, duke llogaritur nga data 23.09.2021, si dita e paraqitjes së padisë në këtë gjykatë e deri në pagesën definitive.

Gjykata ka vendosur si në dispozitivin II, të këtij aktgjykimi me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit lidhur me kërkesat për kompensim për shujtën ditore për 700 ditë pune me 2.50 euro për shujtën ditore apo në shumën e përgjithshme pre 1,750.00 euro sepse me nenin 29 par 1 të UA-së 02/2018, thuhet se *“Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna*

jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”, mirëpo ashtu edhe siç e ka sqaruar edhe Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme nr. 213/2023, të datës 09.10.2023 (Pika I), kjo dispozitë është vetëm e karakterit deklarativ dhe nuk përcakton detyrim konkret për të paditurën, konkretisht nuk përcakton kushtet, lartësinë dhe mënyra e realizimit të shpërblimit të shujtës ditore. Prandaj për këto arsye gjykata ka vendosur që të refuzoj kërkesëpadinë e paditësit lidhur me kërkesën për kompensimin në emër të shujtës ditore.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 449 të LPK-së e po ashtu nenit 452.1, të LPK-së sipas të cilit përcaktohet që *“Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqësore dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore”,* ashtu e paditura duhet që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 104.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore në shumë prej 20.00 euro, në shumë të përgjithshme prej 124.00 euro. Me precizimin e padisë së datës 29.01.2024, paditësi ka kërkuar që të kompensohet në emër të shpenzimeve të procedurës edhe në shumë prej 104.00 euro për parashtresën e datës 29.01.2024, mirëpo këto shpenzime gjykata nuk ia ka njohur sepse ky precizim ishte bërë pasi gjykata me aktvendimin C.nr.1102/2021, të datës 25.01.2024, i’a kishte kthyer në plotësim padinë paditësit, në mënyrë që ta rregulloj saktë kërkesëpadinë, prandaj nuk mund të detyrohet pala e paditur për shpenzime të cilat shkaktohen me fajin e vet paditësit.

Gjykata vendosi që këtë çështje kontestimore ta vendos jashtë seancës gjyqësore ashtu siç është përcaktuar me nenin 398 të LPK-së, e cila parasheh që: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”,* ngase thëniet e paditësit për pjesën aprovuese lidhur me gjendjen faktike për pagën e 13-të u vërtetuan me provat e administruara, të cilat prova janë lëshuar nga e paditura, që nuk janë kontestuar as nga pala e paditur dhe në këtë mënyrë e bënë të themeltë edhe kërkesëpadinë e tij. Kurse fakti se e paditura e ka kontestuar kërkesëpadinë vetëm mbi atë se UA 02/2018 nuk ka përcaktuar detyrim për të paditurën pa pasur mbulesë buxhetore nga Ministria e Financave, nuk është pengesë për të marrë

aktgjykim jashtë seance sepse ashtu siç u theksua më lartë, këto kundërshtime janë prezumime ligjore e jo rreth gjendjes faktike, e të cilat janë të pabazuara.

Ngjashëm me këtë, gjykata duke u bazuar në nenin 399 par 1, të LPK-së ku thuhet se “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija*”, vendosi që me dispozitivin II, të refuzoj kërkesëpadinë e paditësit për shujtën ditore sepse për këtë vendim gjykata është bazuar mjaftueshëm në dispozitat materiale të përcaktuara me UA 02/2018.

Gjykata ka vlerësuar se marrja e aktgjykimit pa mbajtur seancë gjyqësore është në harmoni edhe me praktikën e ndërtuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), e cila praktikë është obligim që të zbatohet nga Institucionet e Republikës së Kosovës. Kjo duke u bazuar në nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku thuhet se “*Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*”.

Në rastin [Jussilia kundër Finlandës](#), nr.73053/01, pika 41, GJEDNJ ka konstatuar se mund të ketë procedura gjyqësore në të cilat mund të mos mbahet një seancë dëgjimore, siç mund të jenë rastet kur nuk janë kontestuese çështjet e besueshmërisë ose fakteve dhe gjykatat mund të vendosin çështjen në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme vetëm në bazë të parashtrësive të palëve dhe materialeve tjera të shkruara, e po ashtu në rastin [Saccasia kundër Austrisë](#), nr.69917/01, pika 76, është konstatuar nga GJEDNJ se mos mbajtja e seancës gjyqësore mund të justifikohet në rastet që ngrenë apo kontestohen thjesht çështje ligjore të një natyre të kufizuar.

Prandaj, duke u bazuar në nenin 398 dhe 399 të LPK-së dhe praktikën e GJEDNJ-së, përderisa e paditura në kundërshtimet e saj me përgjigje në padi ka kontestuar vetëm çështje materiale-ligjore, sipas vlerësimit të gjykatës mbajtja e seancave gjyqësore është e panevojshme, ndërsa vendosja lidhur me çështjen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ka mundur të realizohet mjaftueshëm edhe jashtë seance përmes shkresave të lëndës.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:213650, C.nr.1102/2021, me datë 08.10.2024**

G j y q t a r i

Leotrim Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditësh, pas ditës së pranimimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.